




Raport Vjetor



2007



Raport Vjetor



2007

Mesazhi i kryetarit	7
Ngjarje të Rëndësishme për vitin 2007	8
Struktura Organizative e AAB-së	9
Bordi Drejtues	10
Sistemi Bankar Shqiptar gjatë vitit 2007	11
Aktiviteti i AAB-së	12
- Ekzekutimi i Kolateralit	12
- Bashkëpunimi me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)	13
- Nismat Ligjore	13
- Kontributi për përmirësimin e infrastrukturës operacionale të Regjistrimit të Barrave Siguruese	14
- Përmirësimi i sistemit të raportimit të të dhënave bankare	14
- Përmirësimi i kapaciteteve organizative dhe administrative të AAB-së	14
- Plotësimi i kërkesëve të bankave për trajnime cilësore dhe me kosto të ulët	15
- Rigjallërimi i Nismës për Projekte të Veçanta në Shqipëri (SPI Albania), nën kujdesin e Programit “Convergence” të Bankës Botërore.....	15
- Dërgesat e Emigrantëve.....	15
- Promovimi & Marketingu	16
- Aktivitete brenda Vendlit & dhe Pjesëmarrjet Ndërkombëtare	17
- Konsulencat.....	20
Objektivat për vitin 2008	21
Profili i AAB-së.....	22
Aktiviteti Financiar i AAB-së.....	24
Profili i Bankave në Shqipëri.....	32



Z. Edvin Libohova
Kryetar

Të nderuar kolegë,

Viti 2007 shënoi një tjetër hap të rëndësishëm për konsolidimin e sistemit bankar shqiptar dhe një arritje për vetë Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB).

Gjatë këtij viti, sistemi bankar vazhdoi të ruajë ritme të larta rritjeje në të gjithë aspektet e tij – në totalin e aktiveve, rritjet të degëve, gamës së shërbimeve, vëllimit të kredive, numrit të punonjësve, kapitalit, fitimit, etj.

Grupet e fuqishme bankare si: Intesa-San Paolo (Itali), Société Générale (Francë), Crédit Agricole (Francë), etj, nëpërmjet blerjeve të realizuara në këtë vit, forcuar me tej praninë e kapitalit të huaj në sistemin bankar të vendit dhe i dhanë një tjetër dimension cilësor shërbimit bankar në vend.

Arritjet e vetë Shoqatës Shqiptare të Bankave, gjatë këtij viti, mund të përmbliidhen sa më poshtë:

- Krijimi i dy komiteteve të përhershme teknike, duke forcuar kapacitetin organizativ dhe funksionimin administrativ të AAB-së;
- Krijimi i një platforme parktike dhe të dobishme informuese për të gjithë bankat anëtare, nëpërmjet publikimit, në faqen e saj të internetit, të buletinit mujor të të dhënave bankare;
- Promovimi i mëtejshëm i profilit social dhe profesional të sistemit bankar shqiptar, nëpërmjet ndërmarrjes së nismave mbështetëse për shkollat dhe marketimin e kartave elektronike bankare, etj.

Viti 2008 mbart me vete përgjegjësi të reja dhe mjaft domethënëse për AAB-në, në drejtim të zgjerimit të mëtejshëm të kapaciteteve organizative, orfrimit të një mbështetjeje më të madhe për modernizimin e sistemit bankar, nëpërmjet Nismës për Projekte të Veçanta (SPI), si dhe afrimit më të madh me publikun e gjerë dhe grupet e tjera të interesit.

Shpreh bindjen se ky vit do të forcojë më tej rolin e AAB-së, si një organizëm efektiv për përsosjen e metejshme të vetë funksionimit të sistemit bankar në Shqipëri.


Duke ju falenderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin,


Me respekt,

Edvin Libohova
Kryetar



1. Lehtësimi i procesit të komunikimit midis sistemit bankar dhe autoriteteve të ndryshme rregullatore;
2. Përmirësimi i aspekteve organizative dhe funksionale të AAB-së, nëpërmjet krijimit të dy komiteteve të përhershme teknike (Komiteti Juridik dhe Komiteti i Luftës kundër Mashtrimeve me Kartat);
3. Shndërrimi i AAB-së në një nyje informacioni, nëpërmjet publikimit të Buletinit Mujor të të Dhënave Bankare në faqen e internetit të AAB-së;
4. Ofrimi i trajnimeve me kosto të ulët për bankierët shqiptarë;
5. Ndërmarrja e hapave të mëtejshëm për një rol më aktiv të bankave në tregun e dërgesave të emigrantëve (nëpërmjet publikimit dhe shpërndarjes së informacioneve të dobishme mbi sistemin bankar shqiptar);
6. Hedhja e hapave për krijimin e një partneriteti të frytshëm publik-privat, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes financiare për zhvillimin e programit të ri kompjuterik të Regjistrimit të Barrave Siguruese;
7. Rritja e profilit konsultues të AAB-së, nëpërmjet:
 - i) marrjes së një roli të rëndësishëm në drejtim të formulimit të disa ndryshimeve të rëndësishme në Kodin e Procedurës Civile, për çështjet që lidhen me ekzekutimin e kolateralit në Shqipëri,
 - ii) pjesëmarrjes në Grupin e Punës (të krijuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) për përgatitjen e projektligjit të ri për obligacionet e shoqërive tregtare dhe pushtetit vendor (bashkive),
 - iii) pjesëmarrjes aktivisht në Këshillin Konsultativ të Biznesit, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë & Energjetikës;
8. Promovimi i sistemit bankar shqiptar, nëpërmjet:
 - i) nismës së grumbullimit të fondeve: “Bankat për Internetin në Shkollë”, me qëllim mbështetjen e ngritjes së laboratorëve kompjuterikë dhe të internetit në shkollat e mesme në Shqipëri;
 - ii) transmetimit të një spoti publicitar televiziv, në bashkëpunim me VISA-n, mbi përdorimin e kartave elektronike bankare nga publiku i gjerë.





Z. Edvin LIBOHOVA
Kryetar i Bordit Drejtues

BANKA POPULLORE
Kryetar i Bordit Drejtues



Z. Steven GRUNERUD
Nënkryetar

BANKA RAIFFEISEN
Drejtor Ekzekutiv



Z. Seyhan PENCAPLIGIL
Anëtar

BANKA KOMBËTARE TREGTARE
Drejtor i Përgjithshëm



Z. Dimitris FRANGETIS
Anëtar

BANKA TIRANA
Drejtor i Përgjithshëm



Z. Spiro BRUMBULLI
Anëtar

**BANKA KOMBËTARE E GREQISË
DEGA NË SHQIPËRI**
Drejtor Administrativ

Sistemi Bankar Shqiptar gjatë vitit 2007



Viti 2007 shënoi dhe një vit tjetër të suksesshëm për sistemin bankar shqiptar. Gjatë këtij viti, brenda sistemit bankar pati zhvillime thelbësore e të qenësishme në të gjithë aspektet, duke arritur rekorde thuajse në çdo parameter dhe tregues. Konkretisht, gjatë vitit 2007 depozitat në sistem u rritën më shumë se 27 për qind; rritje kjo e bazuar thuajse plotësisht nga rritja e depozitave të individëve.

Mjetet e sistemit bankar u rritën rreth 20 për qind, duke arritur në mbi 75 për qind të PBB-së.

Kredia për ekonominë, si treguesi më i rëndësishëm, arriti në nivelin rekord prej 2.4 miliard EURO, duke kaluar kështu shifrën prej 30 për qind të PBB-së. Brenda këtij treguesi, një rritje të rëndësishme shënoi huaja për individët, e cila u rrit me 66 për qind, krahasuar me vitin 2006, duke arritur kështu në më shumë se 35 për qind të totalit të portofolit të huave të sistemit bankar.

Rritja e kapitalit aksioner, erdhi si pasojë jo vetëm e hyrjes së disa grupeve të fuqishme ndërkombëtare bankare gjatë 2007-ës, por dhe nga nevoja gjithnjë në rritje për kapital të ri, me qëllim financimin e rritjes së fortë të treguesit të kredisë për ekonominë.

Biznesi i kartave elektronike bankare shënoi përjetoi një zhvillim revolucionar, duke arritur një rritje vjetore të numrit të kartave të emetuara prej 75 për qind, krahasuar me vitin 2006, si dhe duke rritur shumë numrin e POS-eve.

Gjithashtu, bankat vijuan dhe gjatë vitit 2007 të zgjerojnë më tej rrjetin e degëve dhe agjencive në gjithë vendin, duke i ofruar publikut të gjerë dhe bizneseve më shumë akses në shërbimet dhe produktet bankare apo ato financiare.

Treguesi	2006	2007
Totali i mjeteve (mln EUR)	5,071.5	6,068*
në % të PBB-së	69.4%	76.6%
Totali i Depozitave (mln EUR)	4,151.1	5,299*
në % të PBB-së	57%	66.55%
Depozita të individëve (mln EUR)	3,343.4	4,233.3*
në % të PBB-së	46%	53.03%
Kredia për Ekonominë (mln EUR)	1,553.3	2,401.5
në % të PBB-së	21.3%	30.20%
Huatë për biznese (mln EUR)	1,040	1,549
Huatë për individë (mln EUR)	513.3	852.5
Kapitali Aksioner (mln EUR)	342.5	434.7

* Të dhëna operative

Treguesi	2006	2007
Karta	353,465	616,375
- debiti	343,711	603,384
- krediti	9,754	12,991
Nr. i ATM-ve	335	433
Nr. i POS-eve	1,183	1,776

Treguesi	2006	2007
Nr. i punonjësve në banka	4,263	5,206
Nr. i degëve dhe agjencive bankare	292	392
Nr. i banorëve për:		
- bankë	188,235	186,235
- njësi bankare	10,958	8,077
- punonjës banke	751	608



Aktiviteti gjatë vitit 2007

Aktiviteti i AAB-së gjatë këtij viti u fokusua në përmbushjen e objektivave dhe prioritetëve kryesore, të vendosura nga Brodi Drejtues i AAB-së, ndër të cilat mund të përmenden:

Ekzekutimi i Kolateralit

AAB u informua zyrtarisht nga BKT mbi përfshirjen e kësaj të fundit si palë në çështjen gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, lidhur me kushtetueshmërinë e nenit 510, pika d) të Kodit të Procedurës Civile (rreth nxjerrjes së titullit ekzekutiv nga gjykata). AAB pajtoi një studio ligjore (studion ekzistuese të pajtuar nga vetë BKT), me qëllim përfaqësimin e të gjithë sistemit bankar në sesionet e gjykimit në këtë gjykatë. Ky hap u ndërmor për vetë rëndësinë dhe ndikimin total që do të kishte vendimi i kësaj gjykate, mbi gjithë sistemin bankar.

Gjykata Kushtetuese vendosi në favor të BKT-së dhe gjithë sistemit bankar, duke zgjidhur përfundimisht dhe në mënyrë të suksesshme çështjen e nxjerrjes së titullit ekzekutiv nga ana e gjykatave.

Bashkëpunimi me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)

AAB punoi me këmbëngulje për vendosjen e një ure komunikimi me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), me qëllim zgjidhjen e problematikave që hasin bankat me këtë zyrë. Praktikisht, AAB dhe ZRPP mbajtën kontakte të vazhdueshme, duke shkëmbyer komente dhe mendime mbi disa çështje kyçe, që lidheshin me mirëfunksionimin e zyrave të ZRPP-ve, si dhe për sigurimin e një bashkëpunimi më të ngushtë në të ardhmen.



Nismat Ligjore

Shtesat dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile (lidhur me ekzekutimin e kolateralit)

AAB vijoi bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë, në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të propozimeve të vetë AAB-së, lidhur me disa nene të Kodit të Procedurës Civile (KPC) (neni 560, 567, 574 dhe 610). Projekti përfundimtar i ndryshimeve dhe shtesave në KPC përmbante pjesën më të madhe të komenteve dhe propozimeve të AAB-së dhe bankave, duke dhënë kështu premisë pozitive për zgjidhjen e disa çështjeve themelore, që lidhen me ekzekutimin e kolateralit në Shqipëri. Projektligji u dërgua në Kuvend në mars 2007 dhe deri në fund të vitit ishte ende në listën e pritjes për shqyrtim dhe diskutim.

Legjislacioni mbi parandalimin e pastrimit të parave

AAB, në mbështetje të projektligjit të ri “Mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave”, të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), përgatiti një material të hollësishëm me të gjithë komentet dhe sugjerimet e dhëna nga bankat anëtare. AAB organizoi gjithashtu dhe një seminar teknik, ku u diskutuan të gjitha çështjet që lidheshin me legjislacionin mbi parandalimin e pastrimit të parave (për më shumë shihni paragrafin “Aktivitetet brenda vendit & Pjesëmarrjet ndërkombëtare”).

Udhëzimi i ZRPP¹-së: “Për rregullimin e marrëdhënieve me subjektet kredidhënëse, mënyrat dhe procedurat e regjistrimit të kontratës së hipotekimit”.

AAB, në vijim të projektudhëzimit “Për rregullimin e marrëdhënieve me subjektet kredidhënëse, mënyrat dhe procedurat e regjistrimit të kontratës së hipotekimit”, të përgatitur dhe dërguar nga ZRPP, organizoi një takim-diskutimi me juristë të bankave dhe nënpunësve të ZRPP-së, ku u diskutuan gjerësisht aspekte të ndryshme të saj. Praktikisht, ZRPP pasqyrooi në materialin përfundimtar një pjesë të mirë të propozimeve të bankave.

Diskutimi mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, dt. 04 maj 2007

Në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, dt. 04 maj 2007, dhe të paqartësive që mund të krijoheshin nga ky vendim, lidhur me llogaritjen e pagesave të sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punonjësit e bankave, AAB luajti një rol kyç në drejtim të bashkërendimit të përpjekjeve për t'i përjashtuar bankat nga sistemi i pagave referencë, të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Përfundimisht, bankat vijuan të raportojnë në të njëjtën mënyrë, siç vepronin dhe më parë.

Projektligji “Mbi Nënshkrimin Elektronik”

AAB, në vijim të projektligjit “Mbi nënshkrimin elektronik”, të përgatitur nga ekspertët e GTZ dhe dërguar nga METE, përgatiti një material me komente e sugjerime, për këtë qëllim.

Projektligji “Mbi ruajtjen e të dhënave personale”

AAB, bazuar në projektligjin “Mbi ruajtjen e të dhënave personale”, të përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, përgatiti një dokument përmbledhës me të gjithë komentet e opinionet e ekspertëve juridikë të bankave, i cili më pas u dërgua pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe në Kuvend.

¹ Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)



Kontributi për përmirësimin e infrastrukturës operacionale të Regjistrit të Barrave Siguruese

Sekretariati i AAB-së, pas kontakteve fillestare me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë & Energjetikës (METE), diskutoi mbi një mbështetje të mundshme financiare prej 3 milion LEK, për zhvillimin e një programi të ri kompjuterik për Regjistrin e Barrave Siguruese. Bordi Drejtues i AAB-së, e më pas Asambleja e AAB-së vendosi të mbështesë financiarisht këtë nismë të dobishme për aktivitetin e bankave, duke hedhur kështu bazat për bashkëpunim efektiv publik-privat. AAB dhe METE nënshkruan Marrëveshjen e Sponsorizimit në 06 nëntor 2007.

Programi i ri kompjuterik, i propozuar nga METE, është i thjeshtë dhe praktik në përdorim, duke lehtësuar mjaft aktivitetin e përditshëm kredidhënës të bankave. Ai do të zëvendësojë programin e vjetër, i cili aktualisht është jopraktik dhe nuk mund të plotësojë kërkesat dhe aktivitetin kreditues gjithnjë në rritje të bankave.

Përmirësimi i sistemit të informacionit mbi sistemin bankar

AAB, mbështetur në mendimet dhe sugjerimet e bankave, si dhe në bashkëpunim me Departamentin e Statistikave të Bankës së Shqipërisë, përgatiti një bazë të thjeshtë të dhënash operative, në formën e një buletini mujor informacioni për sistemin bankar shqiptar. Ky informacion përmban të dhëna që AAB i merr nga Banka e Shqipërisë, mbi baza mujore, me qëllim shpërndarjen dhe publikimin e tyre nëpërmjet faqes së internetit të vetë AAB-së (<http://www.aab.al/eng/statistika.asp>). Qëllimi i kësaj baze të thjeshtë të dhënash është përdorimi i saj nga bankat, por dhe nga publiku i gjerë, për informim dhe kryerjen e analizave të ndryshme teknike dhe profesionale.

Përmirësimi i kapaciteteve organizative dhe funksionimit administrativ të AAB-së

Në kuadër të rritjes së vazhdueshme të aktivitetit të Sekretariatit të AAB-së, Asambleja e Përgjithshme e AAB-së vendosi, me propozim të Bordit Drejtues të AAB-së, të zhvendosë në ambiente të tjera Sekretariatin e AAB-së, me më shumë hapësira pune dhe mundësi për organizimin e takimeve dhe trajnimeve. Si pjesë e objektivave të AAB-së për zgjerimin e kapaciteteve të saj organizative, Bordi Drejtues i AAB-së, aprovoi në prill 2007, krijimin e dy komiteteve të përhershme: Komiteti Juridik (me kryetare zj. Brunilda Kostare, Këshilltare Juridike e AAB-së) dhe Komiteti i Luftës kundër Mashtrimeve me Kartat (me kryetare zj. Enkelejd Balliu). Këto janë komitete teknike, të krijuar si pjesë e strukturës së Sekretariatit të AAB-së, me qëllim ngritjen e profilit profesional të AAB-së, si dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme bankare në mënyrë sa më efektive (duke mbajtur një strukturë të sheshtë organizative dhe staf të reduktuar brenda AAB-së), duke përdorur eksperiencën e vetë ekspertëve të bankave.



Përbushja e kërkesave të bankave për trajnime cilësore dhe me kosto të ulët

AAB hartoi një dokument me të gjithë nevojat e bankave për trajnimin e stafit të tyre, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e prioriteteve për të siguruar sa më shumë mundësi trajnimi me kosto të ulët për bankat. Përveç kësaj, AAB kontaktoi me Financial Services Volunteer Corps (FSVC), për një bashkëpunim të mundshëm në këtë drejtim. Konkretisht, AAB dhe FSVC organizuan dy kurse cilësore trajnimi në shtator dhe dhjetor 2007 (për më shumë informacion shihni seksionin “Aktivitetet brenda vendit & Pjesëmarrjet ndërkombëtare”).

Rigjallërimi i Nismës për Projekte të Veçanta (SPI), nën kujdesin e Programit “Convergence” të Bankës Botërore

AAB ishte në kontakte të vazhdueshme me drejtuesin e Programit “Convergence”, të financuar nga Banka Botërore, si dhe me drejtuesin e SPI Adriatic, me të cilët u diskutua mbi rigjallërimin e projektit të “SPI Albania”, me qëllim modernizimin e sistemit financiar në Shqipëri, nëpërmjet krijimit të një partneriteti të frytshëm publik-privat.

Projekti i “SPI Albania” pritet të fillojë brenda tremujorit të dytë të vitit 2008.

Dërgesat në Para të Emigrantëve

AAB, si anëtare e Grupit Ndërinstitucional të Punës, të krijuar nga IOM, mori pjesë nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të saj në Analizën Vrojtuese: **“Dërgesat në Para të Emigrantëve dhe Produktet Financiare në Shqipëri: Realiteti dhe e Ardhmja”**². Ndër syimet kryesore të kësaj analize ishin:

- Identifikimi i shërbimeve që u ofrohen familjeve shqiptare që përfitojnë dërgesa në para prej emigrantëve, nga sistemi financiar shqiptar;
- Shqyrtimi i mundësive për qarkullimin e kursimeve të emigrantëve shqiptarë nga kanalet jozyrtare nëpërmjet atyre zyrtare, dhe
- Identifikimi i produkteve dhe shërbimeve të mundshme financiare, që mund të krijohen në përputhje me kërkesat dhe nevojat e emigrantëve shqiptarë dhe të familjeve të tyre në Shqipëri.

Gjithashtu, po në kuadër të këtij projekti, AAB u angazhua në një aktivitet tjetër, që konsistoi në mbledhjen e të dhënave të nevojshme mbi:

- strukturën e trasfertave të këtyre dërgesave,
- aktorët kryesorë në këtë treg,
- mekanizmat e ndryshëm të transferimit të parave,
- ofertat aktuale të bankave për këto dërgesa (shërbime dhe produkte),
- rrjetin bankar në Shqipëri,
- kërkesat respektive të bankave për hapje llogarish,
- afata kohore të mbërritjes së dërgesave pranë bankave shqiptare, etj.

Ky informacion do të shërbente për krijimin e një baze të dhënash në dispozicion të emigrantëve shqiptarë, mbi mënyrat ndryshme për transferimin e parave dhe produktet financiare që ofrojnë aktualisht bankat

² Një kopje elektronike e Analizës Vrojtuese mund të shkarkohet duke klikuar mbi këtë lidhje: <http://www.iomtirana.org.al/Remittance/all/Albania%20Remittances-al.pdf>



në Shqipëri. Ky informacion u publikua në fletëpalosjen: **“Rrjeti Bankar në Shqipëri: Produktet dhe Shërbimet”³**, e cila u shpërnda në komunitetet e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit, pikat e kalimit të kufirit, banka si dhe në institucionet e ndryshme dhe ato qeveritare.

Promovimi & Marketingu

Faqja e Internetit të AAB-së (<http://www.aab.al>).

AAB filloi, nga korriku 2007, publikimin nëpërmjet faqes së saj të internetit të buletinit mujor të të dhënave operative bankare, duke u ofruar bankave më shumë informacion si dhe duke kontribuar për një transparencë më të madhe të sistemit bankar ndaj publikut të gjerë (<http://www.aab.al/eng/statistika.asp>).

Spoti publicitar televiziv

AAB, si pjesë e strategjisë promovionale të saj, përgatiti dhe transmetoi një spot publicitar televiziv, mbi përdorimin e instrumenteve financiarë elektronikë (kartave bankare) nga publiku i gjerë. Spoti u transmetua përmes kanaleve më të ndjekur televizivë në vend, si: TOP Channel, TV Klan, VIZION+ dhe NEWS 24.

Në transmetimin e këtij spoti, AAB u mbështet financiarisht dhe nga VISA International.

Nisma për grumbullimin e fondeve për projektin: “Bankat për Internet në Shkolla”

Kjo nismë u konceptua si një përpjekje për rritjen e mëtejshme të profilit social dhe imazhit publik të sistemit bankar shqiptar si dhe për rritjen e shkallës së njohjes së AAB-së nga publiku. Nëpërmjet kësaj nisme, të gjithë bankat kontribuan me një fond të barabartë prej 3,000 EURO, për ngritjen e laboratorëve kompjuterikë dhe lidhjet e internetit në tre shkolla të mesme, respektivisht në Tiranë, Kukës dhe Korçë. Fondi prej 51,000 EURO iu dhurua zyrës së PNUD-it në Tiranë, e cila ishte përgjegjëse për zbatimin e projektit TIK-Shkolla, së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Njoftimi për shtyp i AAB-së mbi disa komente të mediave rreth mundësive dhe kapaciteteve të sistemit bankar shqiptar për të përballuar volumin e rritur të transaksioneve bankare.

Ky njoftim zyrtar i AAB-së pasoi komentet dhe opinionet e shprehura nga disa media të shkruara dhe elektronike, që vinin në dyshim kapacitetet e sistemit bankar shqiptar për të përballuar volumin e rritur të pagesave dhe transfertave bankare, si rrjedhojë e angazhimeve të qeverisë për reduktimin e ekonomisë jozyrtare dhe kryerjen e transaksioneve të biznesit nëpërmjet kanaleve bankare. Në këtë njoftim⁴, AAB në emër të sistemit bankar shqiptar, deklaroi mbështetjetjen e plotë për të gjithë masat e ndërmarra, me qëllim formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë shqiptare, si dhe shprehu gatishmërinë e sistemit bankar shqiptar për të përballuar me sukses volumin e rritur të transaksioneve bankare, nëpërmjet rritjes së cilësisë së shërbimit për klientët e bankave.

³ Një kopje elektronike e fletëpalosjes mund të shkarkohet duke klikuar mbi këtë lidhje: <http://www.aab.al/eng/documents/BrosurarrjetibankarneShqiperiproduktetdheSherbimet.pdf>

⁴ Një kopje elektronike e njoftimit për shtyp mund të shkarkohet duke klikuar mbi këtë lidhje: http://www.aab.al/alb/documents/NJOFTIMPERSHTYP-Mbikommenteteshtypitrrrethkapacitetevetebankavepertransaksionetshtese_000.pdf



Aktivitetet brenda vendit & Pjesëmarrjet ndërkombëtare

Aktivitetet brenda vendit & Seminare

Sekretariti i AAB, si pjesë të aktivitetit të saj, organizoi, apo bashkëorganizoi një sërë aktivitetesh dhe seminaresh brenda vendit, si më poshtë:

- **Seminari mbi funksionimin e Sistemit të Raportimit të Unifikuar të Bankës së Shqipërisë (BSH).** Ky seminar u organizua dhe u mbështet nga AAB-ja në 28 mars 2007, në vazhdimësi të diskutimeve me Bankën e Shqipërisë rreth problematikave që lidheshin me Sistemin e Raportimit të Unifikuar (SRU), të BSH-së dhe standartet respektive, lidhur me afatet dhe saktësinë e raportimit të të dhënave bankare. Në këtë seminar, nga përfaqësuesit e bankave u ngritën çështje të ndryshme, lidhur me nevojën për përmirësimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, nevojën për trajnime nga ana e BSH-së për SRU-në, vënia në dispozicion të bankave të më shumë informacioneve bankare, etj (sponsore, bashkëorganizatore, mbështetëse).
- **Diskutimi mbi projektligjin e ri “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave” (AAB-DPPPP).** Ky seminar u mbajt më 30 prill 2007, me kërkesë të AAB-së, për organizimin e një seminari me të gjithë aktorët (bankat tregtare, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Banka e Shqipërisë). Ky seminar ofroi mundësinë për të diskutuar mbi projektligjin e ri të hartuar nga DPPPP-ja. Në këtë seminar, përfaqësuesit e DPPPP-së, pas diskutimeve pranuan të përfshinin në projektligj shumicën e propozimeve të bëra nga përfaqësuesit e bankave tregtare (sponsore, bashkëorganizatore, mbështetëse).
- **Diskutimi mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, dt. 04 Maj 2007⁵.** AAB organizoi një takim teknik me juristë të bankave, personat përgjegjës nga Departamentet e Burimeve Njerëzore dhe të Financës të vetë bankave, si dhe dy përfaqësues nga Ministria e Financave, për të diskutuar lidhur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.285, dt.04.05.2007. Ky vendim kishte disa paqartësi e vështirësi lidhur me përlllogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, dhe si rrjedhim ndikonte në rritjen e konsiderueshme të detyrimit tatimor për punonjësit e bankave tregtare (sponsore, bashkëorganizatore, mbështetëse).

Seminare trajnimi të AAB-FSVC (sponsore, bashkëorganizatore, mbështetëse)

AAB, në vijim të objektivit të për t’ju siguruar bankave seminare trajnimi cilësore dhe me kosto të ulët, organizoi dy seminare trajnimi me Financial Services Volunteer Corps (FSVC) dhe USAID, si më poshtë:

1. “Administrimi i kredive dhe rreziku i kredive”, 17-21 shtator 2007

Seminari u fokusua në çështjet dhe temat kryesore, përta i përket kredihënies dhe administrimit të saj, si dhe mbi rrezikun e kredive. Ndër çështjet kryesore që u trajtuan në seminar ishin:

⁵ VKM nr.285, dt.04-maj-2007: “Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe të tatimit mbi të ardhurat personale sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik që kryejnë punë, të pakualifikuara dhe të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e tekniko-ekonomik të tyre” (Fletre Zyrtare nr.59, dt. 18 maj 2007).



- Bazat e procesit të kredidhënies;
- Nënshkrimi i llojeve të veçanta të kredive;
- Administrimi në vijim i kredive;
- Administrimi i kredive me probleme dhe raste studimore;
- Rishikimi dhe Komitetet Simuluese.

2. "Kudri ligjor i administrimit të rrezikut dhe rreziku operacional", 10-13 dhjetor 2007.

Seminari u fokusua në çështjet dhe temat kryesore, përsa i përket kudrit ligjor për administrimin e rrezikut të kredisë dhe rrezikun operacional, si më poshtë:

- Politikat e administrimit të rrezikut kundrejt procedurave respektive;
- Marrëdhënia ndërmjet administrimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm;
- Kudri ligjor për administrimin e rrezikut operacional;
- Bazel II në kontekstin e rrezikut operacional;
- Modelimi i kapitalit;
- Parandalimi i pastrimit të parave;
- Siguria e informacionit & vazhdimësia e biznesit.

Seminaret e Komitetit të AAB-së të Luftës kundra Mashtrimeve me Karta (sponsor, organizator, mbështetës)


Në vijim të krijimit si pjesë e strukturës së AAB-së, ky Komitet organizoi disa seminare teknike, si më poshtë:

1. *Seminare trajnimi, 24-27 shtator 2007.*

Çështjet kryesore të trajtuara në këto seminare njëditore ishin parandalimi dhe zbulimi i pagesave në Shqipëri, nëpërmjet kartave të vjedhura. Në këto seminare, përveç bankave tregtare morën pjesë dhe përfaqësues nga institucionet e zbatimit të ligjit (Policia e Shtetit, Prokuroria). Seminaret u organizuan në Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë, nga 24-27 shtator 2007. Ato u mbështetën teknikisht nga përfaqësues të VISA International, American Express, Master Card si dhe ekspertë të Shërbimeve Inteligjente të SH.B.A-ve.

2. *Seminari Teknik, në Tiranë 05 dhjetor 2007.*

Ky seminar teknik u përqendrua në çështjen: "Udhëzimet e e reja të Standardeve të Sigurisë së Informacionit në Industrinë e Pagesave". Në këtë seminar, përfaqësuesit e VISA paraqitën disa prezantime; gjithashtu këtu u diskutuan dhe disa çështje të rëndësishme, lidhur me krijimin e një formati standard për qarkullimin e të dhënave, statistikave të mashtrimeve me kartat, përmirësimin e "chip"-eve të ATM-ve dhe POS-ëve, etj.



Seminar i përbashkët AAB - Banka e Shqipërisë: “Zyra e Regjistrimit të Kredive – Progresi i projektit”, 24 tetor 2007.

AAB, në bashkëpunim me Departamentin e Mbikqyrjes së Bankës së Shqipërisë, organizoi një seminar teknik me temë: “ZRK – progresi i projektit”, me personat përgjegjës në banka për Regjistrimin e Kredive. Në këtë seminar u bënë dy prezantime, një nga Kryetarja e Grupit të Punës dhe tjetri nga shoqëria “PRONET”, që ishte hartuesi i programit kompjuterik të ZRK. Ata dhanë një informacion të përgjithshëm rreth punës së bërë dhe se çfarë mbetet të kryhej deri në fund të vitit. Seminari vijoi me diskutime mbi çështje konkrete, lidhur me vazhdimin e procesit për ngritjen e ZRK-së, si dhe me problemet që përballëshin bankat në atë fazë (sponsore, bashkëorganizatore, mbështetëse).

Takim-diskutimi i përbashkët AAB – ASD: “Mbi disa çështje lidhur me sigurimin e depozitave”, 17 dhjetor 2007.

Ky takim-diskutimi u organizua nga AAB, në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe u fokusua në çështjet e mëposhtme:

- Edukimi dhe informimi i publikut mbi sigurimin e depozitave;
- Metodologjia e përlogaritjes së primit vjetor për sigurimin e depozitave;
- Forcimi i dialogut midis ASD-së dhe bankave.

Takim-diskutimi u modelua si një forum i hapur, ku specialistët e ASD-së kryen bënë disa prezantime, të cilat u pasuan nga një diskutim i hapur mbi temat e sipërpërmendura. Ky takim-diskutimi u projektua si një platformë standarde për organizimin edhe të takimeve të tjera të diskutimit, nga AAB dhe ASD, në qytete të tjera të Shqipërisë, gjatë 2008-ës (sponsore, bashkëorganizatore, mbështetëse).

Aktivite dhe Prezantime Ndërkombëtare

Gjatë 2007-ës, AAB mori pjesë dhe në aktivitetet e mëposhtme ndërkombëtare:

- Me rastin e Konferencës së 16-të të BACEE (Forumit të Shoqatave të Bankave të Vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore), në Budapest, HUNGARI, më 17-18 prill 2007, z. Seyhan Pencapligil, Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së, bëri një prezantim me temë: “SHQIPËRIA - Ekonomia dhe Sistemi Bankar 2006”⁶.
- Me rastin e Konferencës së 17-të të BACEE (Forumit të Shoqatave të Bankave të Vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore), në Budapest, HUNGARI, më 20-22 nëntor 2007, z. Seyhan Pencapligil, Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së, bëri një prezantim me temë: “SHQIPËRIA - Ekonomia dhe Sistemi Bankar 2007”⁷.

⁶ Një kopje e prezantimit mund të shkarkohet duke klikuar në lidhjen e mëposhtme: <http://www.aab.al/eng/documents/ALBANIA-EconomyandBankingSystem2006.ppt>

⁷ Një kopje e prezantimit mund të shkarkohet duke klikuar në lidhjen e mëposhtme: <http://www.aab.al/eng/documents/ALBANIA-EconomyandBankingSystem2007II.ppt>



• AAB mori pjesë me Kryetarin e saj z. Edvin Libohova, në takimin e 7-të të Forumit Ndërballkanik të Shoqatave të Bankave (IFBA) në Sofi, BULLGARI, në 03-05 maj, 2007, në të cilin u diskutuan çështjet e mëposhtme:

- Vështrim i përgjithshëm mbi ekonominë dhe sistemin bankar bullgar (prezentim nga Shoqata Bullgare e Bankave, ABB);
- Zhvillimi i sistemit të pagesave në Bullgari dhe përgatitja për SEPA⁶-n;
- Mbrojtja e Konsumatorëve në aktivitetin bankar dhe zbatimi i Direktivës së Kredisë Konsumatore;
- Skemat e Garantimit (Sigurimit) të Depozitave dhe skemat e garantimit të investuesve në letra me vlerë;
- Anëtarësimi i Bullgarisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i sistemit bankar;
- Zhvillimet në të fundit rregullatore në rrafsh ndërkombëtar dhe Evropian;
- Tregu Bullgar i kapitaleve dhe roli i Bursës së Bullgarisë.

• AAB mori pjesë me Kryetarin e saj z. Edvin Libohova dhe anëtarin e Bordit Drejtues, z. Spiro Brumbulli, në takimin e 8-të të Forumit Ndërballkanik të Shoqatave të Bankave (IFBA) në Athinë, GREQI, në 09 nëntor 2007, në të cilin u diskutuan çështjet e mëposhtme:

- Zhvillimet në të fundit rregullatore në rrafsh ndërkombëtar dhe Evropian;
- Bashkëpunimi ndërkufitar në rajonin e Evropës Juglindore në fushën e mbikëqyrjes: Eksperienca e Bankës së Greqisë;
- Direktiva e re mbi Kredinë Konsumatore;
- Zona e Njësuar e Pagesave në EURO (SEPA);
- Programet Edukative në gjuhë të ndryshme ballkanike.


Konsulencat

Këshilli Konsultativ i Biznesit

AAB, si anëtare e Këshillit Konsultativ të Biznesit, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), mori pjesë në të gjithë takimet e këtij këshilli dhe paraqiti disa propozime të vlefshme mbi çështje të ndryshme që u diskutuan në këto takime.

Grupi i Punës për përgatitjen e projektligjit të ri “Mbi obligacionet”

AAB, nëpërmjet Sekretarit të saj të Përgjithshëm, mori pjesë rregullisht dhe ofroi propozime të rëndësishme në takimet e Grupit të të Punës për përgatitjen e projektligjit të ri “Mbi obligacionet”. Ky grup pune u ngrit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), me qëllim të përgatitjes së projektligjit për obligacionet e shoqërive tregtare dhe ato bashkiake.



Objektivat dhe prioritetet kryesore të aktivitetit të AAB-së për vitin 2008 janë si më poshtë:

